




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KËSHILLTARE PËR DEKLARIMIN AGENCY FOR DECLARATION	
Dep.:	Nr. Regj.:
Dep.:	03-1838/13
Dep.:	02
Nr.faq:	Data:
Broj. transca:	13.06.2013
Nr. p.ans:	



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI

DEGA NË LIPJAN – OGRANAK LIPLJANE

Regj.nr. 4198/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË LIPJAN, DEPARTAMENTI PËR KUNDËRVAJTJE, sipas gjyqtarit Rustem Begolli duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurës: Vlora Fatmir Limani nga Lipjani, per vepër kundrevajtëse te kryer nga neni 5,6 par.1.3 dhe neni .9, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik e sanksionuar me nenin 17 par 1.3 të ligjit nr.04/L-050, si dhe në mbeshtetje te neneve 73,74, dhe 195 te LMK, me daten 07.06.2013 bjen kete:

AKTVENDIM

E PANDEHURA: Vlora Fatmir Limani i lindur me 05.06.1982 në Lipjan me vendbanim në rrugën te shkolla fillore e serbëve-ndertesa e avokatit nr-4 në Lipjan ku edhe jeton.

ËSHTË PËRGJEGJËSE

Sepse si zyrtare e lartë publik-Këshilltare Komunale-Lipjan nuk e ka permbushur obligimin ligjor mbi deklarimin e pasurisë që parashihet me ligjin 04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë më saktësishtë nuk ju ka permbajtur nenit 9 të këtij ligji.

Me këtë ka kryer vepër kundërvajtëse të sanksionuar nga neni nga neni nga neni 5,6 par.1.3 dhe neni .9, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik e sanksionuar me nenin 17 par 1.3 të ligjit nr.04/L-050.

Ku ne baze te te njejtit nen dhe ligj;

GJOBITET

ME GJOBE, ne shumë prej **300 (treqind euro) €**.

Gjoben e shqiptuar pala eshte e obliguar ta paguaje ne afatin prej 15 diteve, pas plotfuqishmerise se ketij aktvendimi. Gjoba e shqiptuar paguhet ne llogari te buxhetit te konsoliduar te Kosoves nepermes te kesaj gjykate e njejta gjë vlen edhe për paushallin gjyqesore .

Po qe se gjoba e shqiptuar nuk paguhet ne afatin e cekur me larte, e njejta do te zavendesohet me denim burgu duke llogaritur **15 €** per nje dite burg.

Ne emer te shpenzimeve gjyqesore pala eshte e obliguar ta paguaje paushallin gjyqesore prej **5 €** ne afat sikurse gjoben.

Me nga nje ekzemplare te ketij aktvendimi njoftohen pala dhe parashtruesi i kerkeses.

Arsy e t i m

Me kërkesën e Agjencionit kundër Korupcionit në Prishtinë sipas kerkeses nr.01-2203/2012 të dates 04.06.2012 ka kerkuar qe te zhvillohet procedura kundervajtese, kundër të pandehurës **Vlora Fatmir Limani** për kundervajtjen e kryer si në dispozitiv të ketij aktvendimi.

Gjykata në baze të kerkeses së parashtruar, ka hapur proceduren kundërvajtëse dhe ka ftuar dhe marre në pyetje të pandehurën e cila ka deklaruar si në vijim: Është e vertet se brenda afateve ligjore jam e njoftuar se kam pasur për obligim që të ofroj të gjitha dokumentet lidhur me deklarimin e pasurisë pranë agjensisë për anti korupcion . Prej 01 deri me 31 mars kam qenë e sëmurë për arsye se kam qenë shtatzane në atë kohë dhe

po ashtu kamë qenë e shtrirë në klinikën e gjinekologjisë në Prishtinë dhe ate prej datës 14.03.2012 e deri me datën 19.03.2012 për qka edhe ofroj si provë fletë lëshmin nga spitali. Të gjithë dokumentacionin lidhur me pasurinë time brenda agjensisë e kam dorzuar me datë 30.04.2012 për qka edhe ma kanë lëshuar vertetimin. Po ashtu kam ofruar si provë edhe vendimin mbi pushimin mjeksor në kolegjin Pjetër Budi ku shifet se ka munguar në vendin e punës prej datës 07.03.2012 deri me 09.03.2012 dhe gjithashtu nga data 15.03.2012 deri me datën 23.03.2012. Po ashtu ju ofroj si prova materiale që kamë bërë kontrollin gjinekologjik pranë ordinancës gjinekologjike në Shtime të cilat janë nga muaji mars 2012.

Në cilësi të dëshmitarit në gjykatë është ftuar edhe Agron Behrami si përfaqësues i agjencionit për anti-korupcion i cili ka deklaruar: Është e vertetë se me datën 01.03.2012 zyrtarja Valbona A Zeqiri me anë të e-mailit e ka informuar zyrtarin kontaktues pranë Kuvendit Komunal në Lipjan Sami Bytyqi i cili paraprakisht na ka ofruar listën e personave të cilit kanë pasur për obligim që të bëjnë deklarinë e pasurisë pranë agjencionit për antikorrupcion në Prishtinë. Personi kontaktues Sami Bytyqi dhe personat tjerë në teritorin e Kosovës nga data 07-10 shkurt 2012 kanë mbajtur trajnim me qëllim që ti informojnë për procesin e deklarinës të pasurisë. Dua të deklaroj se personi kontaktues Sami Bytyqi neve na ka ofruar listën e personave të cilit janë të obliguar që ta deklarojnë pasurinë, mirpo nuk kemi informat se a i ka informuar personat të cilit kanë për obligim për me deklaruar pasurinë edhe pse e ka obligim ligjor. Dua të deklaroj se deklarimi i pasurisë në bazë të kërkesës së agjencionit për këta zyrtar është bërë në bazë të ligjit nr.04/L-050 i cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011 ku agjensioni në bazë të personit përgjegjës Sami Bytyqi ju ka dërguar të gjitha informata dhe materialet për mënyrën e deklarinës të pasurisë. Në rastin konkret ky zyrtar ka pas për obligim që të deklaroj pasurinë sipas kërkesës së agjencionit.


Në cilësi të dëshmitarit është marë në pyetje edhe Sami Bytyqi zyrtar në Komunën e Lipjanit i cili ka deklaruar: Dua të deklaroj se është e vertetë se kamë qenë personi përgjegjës në Komunën e Lipjanit i cili ka pasur për obligim që të bëjë njoftimin e personave të cilit kanë pasur për obligim që të bëjnë deklarinë e pasurisë pranë Kuvendit Komunal në Lipjan. Dua të deklaroj se njoftimin e deputetëve për obligimin e deklarinës të pasurisë nuk e kam bërë unë por kam shkuar te kryesusi i Kuvendit Komunal e i cili gojarisht e ka marë përgjegjësinë që të bëjë njoftimin e deputetëve për deklarinë e pasurisë, me të cilin kam biseduar dhe i cili është i gatshëm që të vie dhe të dëshmoj pranë kësaj Gjykate.

Gjyqtari gjate vleresimit te seciles prove veq e veq e te gjithave bashkarisht, duke u bazuar ne shkresat e lendes, si dhe ne deklaraten e të pandehurës si dhe të përfaqësuesit të AKK-së dhe të zyrtarit të Komunës së Lipjanit, ka vertetuar se e pandehura ka kryer vepër kundërvajtëse e cila i vëhet ne barre konform me nenin 5,6 par.1.3 dhe neni .9, për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik e sanksionuar me nenin 17 par 1.3 të ligjit nr.04/L-050, ku e njehta e pranon se ka qenë e informuar-njoftuar për obligimin për ta deklaruar pasurinë dhe ku e njehta nuk e ka kryer këtë obligim me kohë, ndaj te cilës shqiptoi gjoben ne shume prej **300 (treqind euro) €**. Konform nenit 109 të LMK-së i shqiptohet paushalli Gjyqësor në shumë prej 5 €. duke shpresuar se me gjoben e shqiptuar do te arrihet efekti pozitiv tek e pandehura që në të ardhmën ti shmangte krytjes se kundërvajtjeve te njetja apo te ngjajshme. Gjykata me rastin e matjes së denimit u bazua në nenin 9 të LMK-së i cili parashef mundësinë e shqiptimit të denimit nën minimumin e parapar ligjor, ku gjykata u bazua në faktin se e njehta megjithat e ka deklaruar pasurinë por pas afatit ligjor, është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe ka qenë shtatzane.

Gjykata konsideron dhe është e bindur së denimi i shqiptuar është konforme ligjit është bazuar edhe në rrethanat lehtësuese dhe rënduese të percaktuara në nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet duke marre për baze sjelljet e të të pandehurës para dhe pas kryrjes së vepres kundërvajtëse, shkallen e pergjegjesis rrezikshmerinë e vepres kundërvajtëse, peshen e veprës kundërvajtëse dhe cilesit personale të të pandehurës.

U GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,DEGA NË LIPJAN,DEPARTAMENTI PËR KUNDËRVAJTJE

KËSHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi mund te parashetrohet ankes Gjykates se apelit ne Prishtine divizionit per kundërvajtje ne afat prej 8 dite nga dita e marrjes se te njejtit, ne permes kesaj gjykate pa taksa.



Gjyqtari
Rrustem Begolli

R B e g o l l i